



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 31 maj 2021, në mbledhjen e tretë (3) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 11:05

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Shpejtim Bulliqi, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z.Isak Ejupi, Komandant i Stacionit të Policisë; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Ndërsa munguan: znj.Albina Avdiu, kryesuese e Komitetit për Komunitete dhe z.Besfort Kruma, toger, përfaqësues i FSK-së.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; Nexhip Jaha, përfaqësues i FSK-së (në zëvendësim të z.Besfort Kruma); z.Driton Veliu, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe z. Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, përshëndetje të gjithëve, pasi që Kryetari është i zënë me punë, ne do të fillojmë me mbledhjen e KKSB-së. Materialet konsideroj i keni marrë të gjithë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24 shkurt 2021

U miratua njëzëri.

2.Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z.Isak Ejupi.

z.Isak Ejupi Komandant i Stacionit të Policisë, theksoi, situata e sigurisë në Komunën e Podujevës vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, pa ndonjë indikacion që në të ardhmen e afërt të ketë ndonjë ndryshim në kuptimin negativ të kësaj gjendjeje. Policia e Kosovës në Podujevë po punon përmes 11 planeve operative në lëmi dhe drejtime të ndryshme për mirëmbajtjen e sigurisë, rendit dhe qetësisë publike dhe në kuadër të kësaj kemi një rritje të angazhimeve operative në terren,

madje në disa prej tyre në përqindje jashtëzakonisht të lartë. Për fat të keq kemi rritje të veprave penale kundër jetës dhe trupit që është një shqetësim i veçantë, po ashtu shqetësim i veçantë për ne por edhe për komunitetin është edhe rritja e veprave penale të dhunës në familje, vepra këto për të cilat policia nuk ka edhe shumë mundësi për parandalim sepse sigurisht se policia nuk mund të futet në familjet për t'i parandaluar ato, por sidoqoftë ato që ndodhin ne po bëjmë përpjekje që maksimalisht ti trajtojmë mirë, duke mos lënë mundësi që të përsëriten. Në kuadër të kësaj ne kemi organizuar edhe trajnime shtesë për stafin që merret me hetimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe aktualisht kemi filluar një trajnim për të gjithë stafin e stacionit, jo vetëm për hetuesit primar të dhunës në familje që janë të thirrur për trajtimin e këtyre rasteve, gjithnjë në funksion të luftës së përbashkët kundër kësaj dukurie.

Në veprat penale kundër pronës kemi rënie, kategori në të cilën ndoshta kam investuar më shumë, për dy arsye, e para është se kryesisht goditen ekonomitë familjare dhe dyta për faktin se përfitojnë një kategori e keqbërësve të cilët janë problem për shoqërinë dhe do të përpiqemi maksimalisht që mos ti lejojmë ata të rriten në grupe dhe në individ që i kryejnë këto vepra. Në këtë periudhë kemi pas angazhime jashtëzakonisht të shumta për sa i përket luftës kundër pandemisë Covid 19 dhe në kuadër të gjitha angazhimeve kemi bashkëpunim të ngushtë edhe me Inspeksionin. Kemi realizuar shumë operacione, shumë kontrolle dhe si rrjedhojë gjatë këtyre tre muajve kemi shqiptuar 2264 gjoba për shkelje të kohës së kufizimit të lëvizjes dhe për mosrespektim të masave anticovid, do të thotë është një angazhim i jashtëzakonshëm dhe permanent në kuadër të zbatimit të planit operativ i cili ka qenë funksional dhe shpresoj se kemi bërë një punë të mirë në parandalimin e zgjerimit të rrjetit të infektuarve. Në ndërkohë kemi rritje edhe të numrit të gjobave sa i përket sigurisë në trafik, në anën tjetër fatkeqësisht kemi rritje të numrit të aksidenteve, por këtë krahasim nuk mund ta marrim me vitin e kaluar sepse e dini se vitin e kaluar në këtë fazë ka qenë e mbyllur komplet, ka pas orë policore, ka pas masa shumë më të rrepta të kufizimit të lëvizjes prandaj numri i aksidenteve ka qenë shumë më i vogël. Këtë nuk po e them si arsyetim, por në raport me vitin 2019 nuk ka ndonjë dallim të madh, është një rritje e lehtë që shkon maksimalisht deri në 4 % varësisht nga muaji në muaj, fjala është për tre mujorin e fundit, nga takimi i fundit. Stacioni Policor në Podujevë në kuadër të vetëdijesimit të qytetarëve për disa kategori për të cilat ne e kemi vlerësuar se është e nevojshme për t'i informuar dhe njëkohësisht për të kërkuar vëmendje prej tyre ka realizuar disa ligjërata në shkollë në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtoritë e shkollave, ku shfrytëzoj rastin t'i falënderoj për bashkëpunimin e mirë që kemi pasur. Kemi realizuar ligjëratat me temat; efektet e narkotikëve, çështjet e trafikut apo sjelljet në trafik, delikuenca e të miturve dhe dhuna në familje. Kanë qenë këto tema të cilat i kemi trajtuar dhe që vazhdojmë. Tash jemi duke ligjëruar në çështjet e trafikut në shkollat më të madha fillore që i kemi në Komunën tonë. Ky aktivitet pas raportimeve të para që ne i kemi bërë në zinxhirin tonë komandues ka marrë përkrahje jashtëzakonisht të madhe dhe ka filluar tash një fushatë pothuajse në tërë Kosovën e që pikënisjen e ka marrë pikërisht këtu në Podujevë. Për këto aktivitete gjejmë përkrahjen edhe të shoqërisë sepse nëse arrijmë të vetëdijesojmë kategorinë e gjeneratave të reja për çështjen e drogave dhe çështjeve tjera që i përmenda, sigurisht që në të ardhmen e afërt mund të kemi më pak raste të tilla se sa që kemi aktualisht. Në kuadër të veprimeve operative ju informoj se si rezultat i kontrolleve të vazhdueshme të pikave të kontrollit por edhe të shtëpive të dyshuarve kemi rritur numrin e rasteve të posedimit të armëve pa leje. Nëpërmes këtyre kontrolleve kemi gjetur në posedim armë pa leje të qytetarët e ndryshëm, e që vlerësojmë se për çdo armë që e kemi marrë do të thotë e kemi larguar një rrezik për publikun, për qytetarët, prandaj dua të ju informoj që në këtë kategori kemi rritje prej 300% dmth, tri herë më shumë kemi konfiskuar armë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pastaj po ashtu kemi rritje cilësore edhe në kategorinë e gjetjes së narkotikëve, në posedim të qytetarëve të ndryshëm, kryesisht të adoleshentët përmes kontrolleve të vazhdueshme që kemi bërë. Ne bëjmë vlerësime dhe analiza në periudha të ndryshme, të shkurtra, javore, mujore dhe tremujore dhe kemi ardhur në përfundim që rritja e numrit në total të veprave që kanë ndodhur në Komunën e Podujevës është më e vogël se rritja në total në nivel vendi. Unë nuk i gëzohem këtij fakti sepse ndoshta atë

dallimin e kanë bërë pikërisht këto veprat penale që i përmenda tash, të armë mbajtjes pa leje, dhuna në familje dhe posedimi i narkotikëve, por megjithatë kam pritë se do të kemi ulje të numrit të veprave penale në total. Sidoqoftë ne do të vazhdojmë të kërkojmë rezultate akoma më të mira në funksion të përmirësimit të gjendjes së gjithmbarshme të sigurisë në Podujevë dhe normalisht që për këtë nevojitet vëmendja e secilit prej nesh. Unë jam i interesuar që në përpjekje për krijimin e sigurisë, për stabilizimin e gjendjes së sigurisë në Podujevë t'i bëjë partnerë të gjithë qytetarët e vendit, para së gjithash një strukturë siç është Komuna që realisht mund të ketë ndikim jashtëzakonisht të madh në situatën e sigurisë së përgjithshme. Planifikojmë që në periudhën e ardhshme, gjatë muajit qershor të mbajmë takimet edhe me KLSB-të në kuadër të parapërgatitjeve për pritjen e bashkatdhetarëve tanë që do të vijnë, e që në kuadër të kësaj kemi përgatitur një plan operativ që ka të bëjë kryesisht me çështjet e trafikut, sepse konsiderojmë se mbyllja e këtij segmenti të dytë të sheshit që është duke u punuar e ka ngulfatur në masë të madhe qytetin dhe po përpiqemi të jemi sa më shumë prezentë në mënyrë që të ndihmojmë që të mos ketë bllokime dhe pengesa në qarkullim të lirë, por njëkohësisht edhe mungesa e parkingjeve publike po shkakton telashe. Në takimin e kaluar me Kryetarin e kam pas një kërkesë që ta kemi një kompani e cila do të merrej me bartjen e veturave nëpër trotuare, sepse ka kundërvajtës që ka marrë deri në 60 gjoba të shqiptuara nga Policia dhe që vazhdon me të njëjtën kundërvajtje, ndërkohë që nga Gjykata nuk po kemi përkrahje, në mënyrë që atyre personave t'i konfiskohet patentat e shoferit apo vetura me qëllim të vetëdijesimit. Ne do të vazhdojmë me kryerjen e punëve dhe detyrave tona në kuadër të sigurisë së përgjithshme të Komunës së Podujevës. Ajo që kërkojmë nga Komuna është plotësimi me disa shenja të rrugëve, e sidomos të udhëkryqeve, sepse disa janë dëmtuar gjatë punimeve e disa tjera nuk kanë qenë të vendosura. Në këtë kontekst veç se kam caktuar një komision në kuadër të Stacionit Policor që do të dal në terren dhe do të ishte mirë që të jetë edhe një ekip nga Komuna, në mënyrë që të krijohet një komision mikst, që të dal dhe të vlerësoj ku kemi nevojë për të plotësuar me shenja dhe këtë infrastrukturë ta kompletojmë. Për momentin nuk kam diçka më shumë, nëse dikush ka ndonjë pyetje, jam i gatshëm për përgjigje.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, nuk kemi asgjë për të raportuar sa i përket gjendjes në Komunën e Podujevës. Ne jemi duke vazhduar punën duke zbatuar mandatin tonë për të sjellë siguri dhe liri të lëvizjes. Shfrytëzoj rastin që të falënderoj për bashkëpunimin e mirë që kemi me të gjitha institucionet në kuadër të Komunës së Podujevës.

Përfaqësuesi i FSK-së, Nexhip Jaha, sa i përket sigurisë në Komunë e Podujevës konsiderojmë se është e qetë dhe stabile. Ne vazhdimisht bashkëpunojmë dhe kemi takime të rregullta me KFOR-in hungarez që është përgjegjës për zonën e Llapit, me qëllim të shkëmbimit të informatave në aspektin e sigurisë. Sa i përket aktiviteteve, FSK gjatë kësaj periudhe kohore ka pas shumë mirëpo në Komunën e Podujevës nuk ka pas ndonjë aktivitet që vlen të përmendet. Jemi të gatshëm gjithherë të kontribuojmë dhe të shërbejmë dhe t'i pranojmë kërkesat që dalin nga ky Këshill, sigurisht për çështjet në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve që kemi.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, nëse keni diçka për të shtuar urdhëroni, nëse jo atëherë kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë për sigurinë në shkolla

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Avni Fetahu.

z. Avni Fetahu, sipas planit të punës së KKSBB –së kemi përgatitur edhe Informatën për sigurinë në shkolla. Drejtoria Komunale e Arsimit synon krijimin e një sistemi arsimor të bazuar në cilësi, gjithë përfshirje dhe llogaridhënie, me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës. Në funksion të kësaj, DKA do të sigurojë infrastrukturë shkollore moderne, mjedis të sigurt, të qetë dhe miqësor, kuadër profesional dhe kompetent për një mësimdhënie cilësore, që do të ju mundësojë të gjithë nxënësve zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre, në pajtim me aftësitë psikike e fizike të tyre dhe me kërkesat e shoqërisë.

Shikuar në përgjithësi, dhe duke u bazuar në raportet e policisë dhe raportet e drejtorëve të shkollave, si dhe raportet e DKA, në lidhje me sigurinë në shkolla, mund të themi se në këtë vit shkollor gjendja e sigurisë në shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë, stabile dhe e sigurt. Këtë konstatim e përforcon edhe më shumë mbarëvajtja e tërë procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Komunën e Podujevës si dhe raportet e drejtorëve të shkollave.

-Mbledhja me drejtorët e shkollave

Në funksion të sigurimit të një mjedisi të qetë dhe të sigurt në institucionet shkollore, drejtori i DKA mbanë mbledhje të rregullta me të gjithë drejtorët e shkollave, në të cilën mbledhje janë trajtohen temat:

Siguria në shkolla – masat për parandalimin e dhunës në shkolla;

Fuqizimi i organeve udhëheqëse dhe profesionale në shkolla;

-Fuqizimi dhe funksionalizimi i plotë i organeve qeverisëse – udhëheqëse dhe profesionale të shkollave

Duke ditur rolin dhe rëndësinë që kanë organet qeverisëse – udhëheqëse dhe profesionale të shkollës në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim, por edhe në sigurimin e një mjedisi të qetë e të sigurt në shkolla, fokus të veçantë i kemi kushtuar dhe do të vazhdojmë t'i kushtojmë fuqizimit dhe funksionalizimit të plotë të tyre (Drejtorët e shkollave, Aktivet Profesionale, Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli i Nxënësve, Këshilli i Klasëve, Këshilli i Arsimtarëve, Shërbimi Pedagogjik-Psikologjik), me qëllim që këto organet ushtrojnë funksionin e tyre në ngritjen e cilësisë në arsim dhe në krijimin një mjedisi të qetë dhe të sigurt në shkolla.

Në këto mbledhje është konstatuar gjendja e sigurisë për secilën shkollë, si dhe propozimet dhe rekomandimet që kanë dalë nga ky takim janë përmbledhur në një raport nga secila shkollë dhe janë sjellë në DKA. Bazuar në këto raporte mund të konstatojmë se gjendja e sigurisë në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë dhe e sigurt.

-Zgjerimi i shërbimit psikologjik dhe pedagogjik

Në Komunën e Podujevës kemi të punësuar 3 psikologë dhe 1 pedagogje, e që shikuar në raport me numrin e nxënësve në Komunën e Podujevës është i pamjaftueshëm.

Gjatë këtij viti kemi zhvilluar procedurat e konkursit për punësimin edhe të katër psikologëve në shkolla.

-Sigurimi i transportit të nxënësve

Komuna e Podujevës siguron transport të organizuar për të gjithë nxënësit që kanë distancë nga shtëpia në shkollë mbi 4 km., si dhe për fëmijët me nevoja të veçanta, në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, që i vijnë mësimet në klasat për fëmijët me nevojat e veçanta, në shfmu “Kongresi i Manastirit” në Gllamnik.

-Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkollore

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës moderne, mjedisit të sigurt dhe miqësor për nxënë, Komuna e Podujevës, në kuadër të planifikimeve të saj, edhe për këtë vit ka ndarë buxhet për ndërtimin, zgjerimin dhe renovimin e hapësirave shkollore.

-Rregullimi i rrethojave të oborreve të shkollave

Rrethojat e oborreve të shkollave ndikojnë në ngritjen e sigurisë së shkollave, dhe duke marrë parasysh këtë fakt, Komuna e Podujevës ka bërë investime të konsiderueshme në këtë drejtim. Shumica e shkollave kanë rrethojat e tyre, mirëpo ne do të vazhdojmë edhe këtë vit të ndërtojmë rrethojat edhe në ato shkolla ku rrethoja është e dëmtuar apo nuk kanë fare.

z. Isak Ejupi, ne kemi planin aktiv të sigurisë në shkolla, por në kuadër të forcimit të sigurisë në shkolla dhe rreth objekteve shkollore, besoj se së shpejti do të fillojmë edhe me zyrtarin policor të tretë, që do të jetë ndihmesë shtesë në realizimin e kësaj sigurie. Unë kam pas një takim me drejtorë të shkollave, gjithnjë në përpjekje për të krijuar linjën e komunikimit në mënyrë që për çdo situatë që mund të jetë e papranueshme në ambientet shkollore të reagojmë me kohë për të parandaluar çdo incident të mundshëm atje, kështu që bashkëpunimin po vazhdojmë ta mbajmë në komunikim permanent me Drejtorët e shkollave, njëkohësisht edhe me Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, në mënyrë që siguria mos të jetë pengesë për zhvillimin e procesit mësimor.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, nëse keni diçka për të shtuar urdhëroni, nëse jo atëherë kalojmë në pikën e radhës.

4.Informatë lidhur me gjendjen e Pandemisë - Covid 19 në Komunën e Podujevës

- Shëndetësia

- Arsimi

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, fillimisht fjalën ia kalojmë Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale z.Driton Velu

z.Driton Velu drejtor i DSHMS, siç jeni në dijeni gjendja epidemiologjike javëve të fundit është përmirësuar dukshëm. Sa i përket statistikave për gjendjen epidemiologjike, që nga dita e parë e paraqitjes deri më sot në total kemi 4515 raste të konfirmuar pozitiv me virusin covid 19, prej tyre kemi 4438 raste të shëruar, 16 raste aktive dhe 61 raste të vdekjes. Në dy javët e fundit kemi një përmirësim dhe një rënie drastike të rasteve të konfirmuara pozitiv. Pra dy javët e fundit kemi vetëm 16 raste të konfirmuara pozitiv. Sa i përket vaksinimit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare deri më tani i kemi vaksinuar mbi 2200 persona, është fjala për vaksinimin e personave mbi 65 vjet. Në listën e pritjes kemi afër 1000 persona të cilët do ti vaksinohet gjatë ditëve në vijim, ndërsa sa i përket vaksinimit masiv që pritet të fillojë në fund javë apo fillim të javës së ardhme në bazë të rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë ne e kemi caktuar si lokacion sallën e sportit në shkollën “Xheladin Rekalu”, ku do të vendosen 8 ekupe, prej tyre 4 në ndërrimin e parë dhe 4 në të dytin. Sipas statistikave dhe eksperiencës që kemi kaluar një ekip arrin mesatarisht të vaksinon 70 persona, e që gjatë ditës parashohim të vaksinohet deri 700 persona. Së pari do të vaksinohet pjesën e mbetur të personave mbi 65 vjet, pastaj do të vazhdojmë me vaksinim sipas planit shtetëror të Republikës së Kosovës dhe rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë, ku fillimisht do të fillojmë me punëtorët e arsimit, personelin policor, atë të administratës dhe strukturat të punës, e pastaj do të vazhdojmë me pjesën tjetër të popullsisë. Fokusi ynë është që të arrijmë vaksinimin mbi 61 % të numrit të popullsisë. Gjithashtu vlen të theksohet se kemi bërë planin tonë të punës, ku në bazë të listave të pritjes, që t’i ikim grumbullimit, do ti selektojmë me grupe 10/10, pra duke specifikuar ditën dhe orën. Pas pranimit të listave nga institucionet, do ti selektojmë në grupe dhe për ditën dhe kohën e vaksinimit do u transmetohet institucioneve.

z. Avni Fetahu, theksoi, procesi mësimor në kushte pandemie, në Komunën e Podujevës është duke u zhvilluar sipas tre skenarëve apo modalitete të rekomanduara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Sipas skenarit A (mësimi në shkollë me orar dhe përmbajtje të reduktuar) organizohet pothuajse në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën e Podujevës, me përjashtim të shfmu “Naim Frashëri” Podujevë dhe shfmu “Dr. Ibrahim Rugova” Podujevë, shkolla këto që mësimin për klasët VII, VIII dhe IX e zhvillojnë sipas skenarit B (ku mësimi zhvillohet rrotacion në shkollë dhe në distancë). Sipas skenarit B mësimin e zhvillojnë edhe tri shkollat e mesme të larta, njëri grup e vijon në shkollë, kurse grupi tjetri nga distanca, me rrotacion një javë njëri, një javë grupi tjetër.

Sipas skenarit C (mësimi nga distanca) zhvillohet në rastet kur paraqitet ndonjë rast pozitiv me COVID-19 në klasë apo në shkollë, atëherë pas analizës dhe vlerësimit të gjendjes pandemike, klasa apo shkolla komplet mësimin e vijon nga distanca (dy klasë në shmlt “F. S. Noli”, një klasë në shfmu “Musli Dumoshi”, gr. parafillor në “Sh. Shala”).

Komuna e Podujevës, gjegjësisht Drejtoria Komunale e Arsimit, në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t’i krijuar kushte për punë dhe mësim. Dezinfektimi i objekteve shkollore vazhdon dhe bëhet çdo javë, ndërsa sa i përket furnizimeve Drejtoria Komunale e Arsimit ka bërë me kohë furnizimin shkollave me materiale për higjienën, si dhe me materiale anti COVID (dorëza, maska, dezinfektues, termometër etj.)

Në shkollat e Podujevës, momentalisht kemi katër mësimdhënës që kanë rezultuar pozitiv në testin për COVID (2 në shfmu “Dr. I. RUGOVA”, 1 në shfmu: “Xh. Rekalu” dhe 1 në shfmu “Pavarësia”), si dhe kemi tre nxënës me COVID (2 në shmlt “Fan S Noli”)

z. Nuhi Selimi, theksoi, a ka mundësi për angazhimin e ndonjë ekipi të veçantë apo mobil shëndetësor për zonën e fshatit Orllan, sepse ardhja e banorëve nga ajo pjesë por edhe regjistrimi online, sikurse e theksuat do të paraqet vështirësi. Pra fjala është pse të vijnë banorët në qytetin e Podujevës kur të njëjtat mund të vaksinohen edhe në Orllan.

z.Driton Veliu drejtor i DSHMS, lidhur me pyetjen e parafolësit ju njoftoj se në bazë të marrëveshjes që kemi me Ministrinë e Shëndetësisë mendojmë se së shpejti do të ngritet edhe ndonjë ekip mobil për vaksinimin e banorëve në pjesë të thella të zonave rurale por edhe personat/pacientët që kanë probleme të rënda shëndetësore (të lëvizjes). Pra do të shqyrtohen mundësitë që edhe në Orllan, Kërpimëh dhe Lluzhan të vendosim ekipe për vaksinim, por kjo do të bëhet pasi që të rrisim numrin e mjekëve sepse kemi mungesë të mjekëve.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, nëse keni diçka për të shtuar, atëherë kalojmë në pikën e radhës, e që në këtë temë fjalën fillimisht ia kalojmë përfaqësuesi të Bashkësisë Islame z. Mensur Hoti.

5.Informatë rreth zbatimit të Planit operativ lokal sipas Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm

z.Mensur Hoti, Bashkësia Islame sa i përket ekstremizmit të dhunshëm, ka shprehur gatishmëri për bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit dhe çdo herë është munduar për mos t'i dhënë hapësirë ekstremizmit në Komunën e Podujevës. Nëse kësaj çështjeje i bëjmë një vlerësim në nivel të Kosovës, ndoshta jemi Bashkësia Islame e vetme në Podujevë që nuk i kemi dhënë rast, as nuk kemi të emëruar asnjë imam me pikëpamje dhe orientim ekstremist. Bashkësia Islame edhe në të kaluarën ka dëshmuar një gjë të tillë, nuk jam në dijeni sa jeni të informuar, fjala vjen, tendencat për ndërtimin e një xhamie në fshatin Revuçë, duke ju falënderuar bashkëpunimit që ka pas BI me pushtetin lokal në Podujevë, ka arrit të pezullojë punën dhe nuk është arritur qëllimi i tyre. Edhe më tutje BI do të vazhdojë, do të jemi bashkëpunues me pushtetin komunal dhe me institucionet e vendit. Si BI nuk kemi vërejtur diçka që vlen të alarmohet. Para ca ditësh me Policinë e Kosovës kemi pas një takim dhe jemi në bashkëpunim çdo herë lidhur me këtë çështje.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, falënderojmë përfaqësuesin e Bashkësisë Islame për informatën e paraqitur, të shohim nëse Komandanti i Stacionit të Policisë dhe Drejtori i Drejtorisë së Arsimit kanë për të shtuar diçka.

z. Isak Ejupi, ne vazhdojmë me mbajtjen e takimeve me të gjitha kategoritë duke përfshirë edhe imamin z. Mensur Hoti. Edhe në të kaluarën kemi pas një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë. Si rezultat Komuna e Podujevës ka qenë më pak e kontaminuar me element që kanë prirje të kështu që situatën edhe ne e vlerësojmë të qetë, sigurisht falë këtij bashkëpunimi.

z. Avni Fetahu, mendoj se kjo është dashur të trajtohet si temë e natyrshme, sepse besoj se ka rënë ai trend i shkuarjes së personave dhe që ka shpie në terrorizëm. Mendoj që është mirë t'i jepet një epilog këtij plani operativ se si është zhvilluar, për periudhën e mëhershme, sepse edhe ashtu i ka skaduar afati, ka qenë deri më 2020.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, nëse nuk keni diçka për të shtuar, atëherë kalojmë në pikën e radhës.

6. Masat parandaluese dhe senzibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrje-shirjeve dhe djegieve të pyjeve dhe vërshimeve (Koordinimi i aktiviteteve në mes DBPZHR, DSHPMSh, SZSH, Policisë, Agjencionin pyjor, Agjencionin e Menaxhimit Emergjent).

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, për këtë pikë fillimisht fjalën ia kalojmë Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Vigan Salihut.

z. Vigan Salihu, theksoi, në vitin 2020 kemi pas 44 raste në sipërfaqe prej 267 ha dëme të shkaktuara nga zjarret, ndërsa në kohën që po raportojmë deri më tani i kemi 9 raste në sipërfaqe 56.60 ha, e gjithë kjo duke iu falënderuar kushteve të mira atmosferike pra reshjeve të borës, shiut që kanë mbizotëruar këtë pranverë si dhe koordinimit të punëve mes neve. Tani me fillimin e

vegjetacionit mundësia e shfaqjes së zjarreve në pyje dhe toka pyjore është më e vogël, pra me një koordinim më të mirë ne mund të ia dalim dhe të zvogëlojmë në minimum shfaqjen e tyre. Nga rojet e pyjeve që janë përgjegjëse në terren, nëpër zonat ku kufizohet Komuna jonë me Mitrovicën , Leposaviqin dhe Republikën e Serbisë kemi pranuar informata të ndryshme në lidhje me qarkullimin e masës drusore si pasojë e kalimeve ilegale nga kufiri. Kjo masë drusore është duke na krijuar probleme të mëdha për arsye se po kemi ngatërresa dhe përzierje me masën drusore të territorit të Kosovës dhe përzierje të masës drusore të prerë në ngastrat private dhe ato publike. Gjithashtu dua të ju njoftoj se është përcjellë edhe masa drusore për shitje me ankand publik përmes Zyrës së Prokurimit, fjala është për masën drusore të rënë nga vërshimet dhe ajo e konfiskuar dhe e vendosur në depo në fshatin Peran.

z. Fevzi Jetullahu, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, përkatësisht sipas informatave zyrtare të Shërbimit të Zjarrfikësve kemi pasur 46 intervenime në rastet e djegies së pyjeve, 51 raste të djegies së fushave dhe në toka bujqësore janë 6 raste.

z. Isak Ejupi, theksoi, për çështjet që i takojnë kompletimit të strukturës por edhe të mekanizmave logjistike të zjarr fikjes e kemi një gjendje jashtëzakonisht të keqe, ndërkohë që është një institucion i domosdoshëm dhe me një rrezikshmëri të lartë. Punëtorët e Shërbimit të Zjarrfikësve punojnë në kushte që me të vërtetë nuk janë të favorshme por para së gjithash edhe mekanizmi me të cilin punojnë është i vjetërsuar, nuk i përgjigjet nevojave. Ne jemi komuna me territorin më të madhin në Kosovë që pjesa dërmuese është kodrinore- malor dhe realisht nëse i kemi dy reagime në drejtime të ndryshme dhe çfarëdo që të ndodhë në ndërkohë është në mëshirën e askujt. Është mirë të alarmohet kjo çështje, e di që është edhe çështja e kompetencës së dyfishtë, e Ministrisë dhe e Komunës, pra është e nevojshme së pari të rregullohet statusi i tyre pak me urgjencë në mënyrë që pastaj të dihet se kush është përgjegjës me menaxhua dhe me i kompletuar me pajisje.

z. Fevzi Jetullahu, sa i përket Shërbimit të Zjarrfikësve, është fakt se është mungesë jashtëzakonisht e madhe e stafit, ku kemi kërkuar nga Niveli qendror që të na mundësohet rritja e numrit të punëtorëve, sepse për momentin për gjendjen çfarë e kemi prej 3-4 vetave në një ndërrim është e pamundur për t'i ardhur rreth gjithë atyre problemeve që mund të paraqiten. Mendoj se si këshill është mirë të i drejtohem Ministrisë sa i përket çështjes së Zjarrfikësve të cilën e potencuam sepse është një problem shumë i madh.

z. Isak Ejupi, unë pajtoj plotësisht për atë që theksoi parafolësi sepse gjendja e Shërbimit të Zjarrfikësve është e papranueshme.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, nëse keni diçka për të shtuar, atëherë kalojmë në pikën e radhës.

6. Të ndryshme

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, fjalën e ka z. Nuhi Selimi.

z. Nuhi Selimi, theksoi, fjala është për rrugën Orllan – Ballaban. Këtë çështje e kemi ngritë disa herë por askush nga Komuna nuk është interesuar për të ndërmarrë masa. Rruga paraqet rrezikshmëri të lartë në tre vende, për shkak të shembjes. Për këtë është i njoftuar edhe Komandanti i Policisë. Ndërsa si kërkesë e dytë është shqyrtimi i mundësive për shtimin e numrit të zyrtarëve policor në pjesën e orllanit, sidomos tash gjatë sezonit veror, është shumë e nevojshme, edhe pse jam në dijeni se Policia ka vështirësi sa i përket numrit të zyrtarëve policor. Gjithashtu dua të potencoj edhe çështjen e pastërtisë të Liqeni i Batllavës. Çdo vit janë angazhuar punëtorë për pastrimin dhe mirëmbajtjen e liqenit, ndërsa këtë vit nuk jam në dijeni se çka është ndërmarrë. Tash veç se ka filluar gravitimi i qytetarëve në atë pjesë dhe fatkeqësisht prej tyre ka të pandërgjegjshëm ku hedhin mbeturinat, por ka edhe të tillë që janë të kujdesshëm. Çështjen e pastërtisë duhet ta kemi parasysh.

z. Fevzi Jetullahu, sa i përket çështjes së rrugës Orllan-Ballaban, të cekur nga parafolësi, kjo është në kompetencë të Ministrisë e jo e Komunës. Mirëpo vlen të theksohet se gjatë vitit ne kemi intervenuar dhe e kemi mirëmbajtur atë pjesë. Për këtë çështje jemi në bisedime me Ministrinë e

infrastrukturës, në mënyrë që nga ana e tyre të angazhohen kompanitë për mirëmbajtjen e rrugës dhe për sanimin e atyre dëmtimeve. Pra dua të ritheksoj se e kemi ngritë këtë çështje me Ministrinë e Infrastrukturës dhe presim shumë shpejt përgjigje nga ana e tyre sepse është një investim shumë i madh dhe është shumë e nevojshme mirëmbajtja e saj.

Sa i përket angazhimit të punëtorëve për mirëmbajtje të Liqenit të Batllavës, është fakt se çdo vit kemi angazhuar punëtorë, mirëpo kontrata mbi vepër tani më nuk ka dhe për këtë kemi kontaktuar me APK-në që në kuadër të mundësive të angazhojë së paku dy punëtorë. Ndërsa sa i përket mbeturinave në atë zonë, së shpejti do të lidhet kontrata e prokurimit dhe do të bëhet largimi i tyre.

z. Isak Ejupi, theksoi, unë personalisht kam dal në vend të ngjarjes atje ku janë shkaktuar dëmtimet në rrugën Orllan – Ballaban dhe kam kërkuar nga operativa që të parashtrojë kërkesë në Ministri për sanimin e dëmeve. Nëse e kemi adresuar si problem dhe nuk është zgjidhur problemi praktikisht ne e kemi informuar dhe detyrë e jona është për të informuar sikurse është vepruar edhe nga ana e Drejtorit. Pse nuk kanë ardh nga Ministria mbetet përgjegjësi e tyre. Pra unë personalisht kam dalë në vend ngjarje dhe kam parë situatën, e keqe është dhe e rrezikshme por shpresoj që së shpejti do të aktivizohet Ministria.

z. Qefser Behrami, theksoi, në rajonin e fshatrave të cilat i përfaqësoj kemi halle të cilat jam i detyruar ti prezantoj në Këshill.

Fillimisht fjala është për hedhjen e mbeturinave. Unë personalisht kam hasur në një person dhe e kam fotografuar i cili me karrocë dore hodhi mbeturinat. Kam kërkuar edhe nga banorët që rastet të tilla t'i konstatojnë, t'i fotografojnë dhe të i përcjellin te unë, ndërsa unë te autoritetet. Çështje tjetër janë qentë endacak, çdo herë jam duke e trajtuar këtë çështje dhe ka raste kur po i sulmojnë nxënësit.

Çështja tjetër ka të bëjë me pendat e ndërtuara. Si të tilla janë të mirëseardhura dhe të qëlluara, por konstrukti i tyre nuk është në nivel. Aty duhet bërë një ndryshim, shpim sepse çdo herë që ndodhë një vërshim atë herë në tërë ato ara shkaktohet dëm i madh. Si të tilla vlen të ndërtohen për vendet e perëndimore ku nuk hedhen mbeturinat e jo te ne.

Gjithashtu kam kërkesë prej disa qytetarëve që të përcillet te autoritetet, çfarë është problemi që të gjithë ata persona që nuk kanë pasuri të vetën pyjore çdo ditë shesin dru. Është duke u bërë shkatërrim total i pyjeve si në sektorin privat ashtu edhe atë shtetëror.

Përfundimisht dua të paraqes edhe një rast, fjala është për një familje në fshatin Kërpinë, ku e tërë familja nuk janë në nivel mental. Ka raste kur sulmojnë banorët dhe kjo ka ndodhë edhe personalisht ndaj meje. Kjo familje paraqet rrezikshmëri për banorët, kështu që duhet ndërmarrë diçka.

z. Driton Velu, sa i përket familjes me të meta psikike të cekur nga parafolësi, duhet ditur cila është ajo familje, në mënyrë institucionet relevante të marrin masa dhe të veprojnë, ndërsa kur është fjala te gjuajtja me gurë dhe gjësende të forta adresa është Policia e Kosovës.

z.Fevzi Jetullahu, për çështjen e mbeturinave siç u cek nga z. Qefser Behrami, ne jemi në pritje të nënshkrimit të kontratës së prokurimit dhe do t'i largojmë deponitë ilegale, ndërsa sa i përket shqetësimit nga qentë endacak, ky është problem i madh, ne kemi një buxhet të kufizuar dhe nuk mund t'i trajtojmë në masë siç e kërkon nevoja.

z. Qefser Behrami, sa i përket hedhjes së mbeturinave, nuk është hera e parë që largohen deponitë ilegale, por kjo dukuri prapë do të vazhdojë. Është nevojshme të dal një komision komunal dhe të konstatojë se kush bënë pagesat e shërbimit të largimit të mbeturinave dhe kush jo, Komuna duhet të ndërmarrë masa lidhur me këtë, sepse të gjithë ata banorë të cilët nuk bëjnë pagesat e shërbimit të bartjes së mbeturinave, janë të njëjtit që i hedhin.

z.Fevzi Jetullahu, theksoi, si Drejtori e SHPMSH jemi duke u marrë me çështjen e pagesave për bartjen e mbeturinave por edhe me çështjet që u potencuan nga parafolësi.

Nënkryetarja përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00
Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr. 02-060/04-0043408/21
Podujevë, 31 maj 2021

Nënkryetarja e Komunës
Marigona Lahu